


FORMA MË E MIRË E QEVERISJES



VENDIMMARJA NA TAKON NEVE

BLEART (9), RAJANA (11), LEON (10), RINESA (10), ERTA (10), LUIZA (10), ARDIT (10), RRON (10),
LORIK (10)




Ne kemi shumë të drejta në demokraci, por duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të kemi respekt për njëri-tjetrin

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Në demokraci, vullneti i popullit është baza për ndërtimin e shtetit. Ana është veterinarë shumë e suksesshme. Që nga fëmijëria i pëlqente shumë kafshët dhe lënda e saj e preferuar ishte „Njeriu dhe Natyra“. Ajo ishte nxënësja më e mirë në klasë. Kur ajo u rrit, u diplomua si veterinarë. Punën e saj ajo e kryen me shumë përgjegjësi dhe me kënaqësi, sepse ishte ëndrra dhe dëshira e saj për një kohë të gjatë. Pra, ajo kishte të drejtën për ta zgjedhur profesionin që shumë e pëlqente. Për shkak se Ana jeton në një vend demokratik, ëndrra e saj u realizua.

Kosova është vend demokratik dhe ne si qytetarë të Republikës së Kosovës duhet të jemi të përgjegjshëm

për veprimet që ne i bëjmë. Këtu hyn edhe respektimi i ligjeve. Ligjet janë rregulla që të gjithë qytetarët duhet t'i respektojmë. Në një vend pa ligje, do të ndodhnin shumë aksidente, vjedhje, etj. Kështu pra, të gjithë do të ishim të pasigurtë. Prandaj, rëndësia e ligjeve është e madhe, sepse ato na rregullojnë jetën tonë dhe na mundësojnë që të kemi një jetë më të mirë.



Ne kemi të drejtën e shkollimit dhe përgjegjësia jonë është që të mësojmë sa më shumë



Bashkimi bën fuqinë



Gazetarët e ardhshëm

TË DREJTAT TONA MBROHEN ME LIGJ

TRINGA (10), ERMAL (11), SUMEJA (10), ART (10), SUELA (10), DION (10), DINA (10), DONART (10),

MELISA (11)



Fëmijët janë e tashmja dhe e ardhmja

Lumturia është diçka të cilën çdo njeri në botë e dëshiron. Nëse në familjet tona ka lumturi, atëherë aty do të ketë edhe harmoni.

Lumturia rrjedh nga dashuria e anëtarëve të familjes për njëri-tjetrin, nga respekti i ndërsjelltë, si dhe nga ndihma që ne i ofrojmë njëri-tjetrit.

Të gjitha këto veti, i gjejmë si vlera në demokraci. Çdo qytetar i cili jeton në një shtet demokratik, është i privilegjuar, sepse aty i mundësohen shumë të drejta. Por, edhe ne si fëmijë kemi të drejta të cilat mbrohen me ligj.

Ne ndjejmë dhembje të thellë për të gjithë fëmijët e botës të cilëve iu mohohen disa të drejta. Marrim shembull në Siri, shumë fëmijë obligohen të largohen nga shtëpitë e tyre, sepse nuk ndjehen aspak të sigurtë, meqenëse në shtetin e tyre ka luftë.

Kjo nuk është aspak e drejtë, sepse çdo fëmijë i botës ka të drejtë të ketë një jetë normale dhe të jetojë në qetësi.

Përmes këtij artikulli, ne u bëjmë thirrje të gjithë personave kompetent të cilat merren me të drejtat e fëmijëve, që të marrin masa dhe t'i shpëtojnë fëmijët të cilëve u rrezikohet jeta çdo ditë.

Ne e duam një botë demokratike, e jo luftë. Ne besojmë në mirësinë e njerëzve, prandaj kërkojmë që të

gjithë të ju të na bashkoheni në këtë thirrje për shpëtimin e fëmijëve anë e mbanë botës.



Roli i gazetarit na bëri edhe më të përgjegjshëm

E DREJTA E VOTËS SË LIRË


ERA (10), LEONITA (10), LEART (10), ENSAR (10), RINESA (10), DONAT (10), KRENAR (10), BARDH (10)

Ne si gazetarë të demokracisë, do t'iu tregojmë për zgjedhjet në Kosovë. A dëshironi të mësoni për këtë temë? Atëherë, ju mund të lexoni këtë artikull

Zgjedhjet janë shumë efektive dhe të rëndësishme, sepse përmes tyre ne duhet t'i zgjedhim përfaqësuesit të cilët na i plotësojnë nevojat tona. Prandaj, ne votën duhet t'ia japim atij personi i cili i përmbush kërkesat tona. Në Kosovë kemi: zgjedhjet lokale (komunale) dhe zgjedhjet parlamentare (qendrore).

Ligjet nuk i vendos kryetari i komunës, por ligjet i vendosin vetëm deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në Republikën e Kosovës nuk mund të dalë të votoj një qytetar i cili është nën moshën 18 vjeçare. Kjo sepse në këtë moshë ne jemi më të pjekur. E nëse i japim dikujt votën dhe pastaj pendohemi, ne votën nuk mund ta nxjerrim nga kutia. Votuesi voton atë kandidat që e meriton. Ai mund të jetë një kandidat që e mban fjalën dhe që është i sigurtë me popullin. Në shtetin tonë nuk detyrohemi me ligj që të dalim të votojmë. Qytetarët mund të dalin të votojnë sipas dëshirës. Nëse ne e votojmë një kandidat i cili thotë se: „Unë ua plotë-

soj nevojat tuaja“ dhe nuk i plotëson ato, atëherë ne në zgjedhjet e ardhshme nuk duhet t'ia japim votën, por duhet ta votojmë kandidatin më të mirë dhe më të përgjegjshëm për ta udhëhequr shtetin. Zakonisht, ashtu si më ka treguar mami dhe babi zgjedhjet mbahen në ditën e diel, në objektet e shkollave kur nxënësit nuk kanë mësim. Kur hyjnë në vendvotim, qytetarët iu nënshtrohen disa procedurave të kërkuara në procesin zgjedhor. Në klasën ku kryhet votimi, janë njerëzit që votojnë dhe ata të cilët e kontrollojnë këtë proces. Për të votuar, ne duhet të kemi një letërnjoftim. Në klasën e votimit, po ashtu janë kabinat ku qytetarët votojnë individualisht. Në fund, fletën e votimit e vendosin brenda në kuti. Ne jemi fëmijë dhe nuk kemi votuar më parë, por kemi marrë pjesë në zgjedhjet e klasës të cilat ishin shumë demokratike dhe të drejta. Prandaj, ne ju ftojmë të votoni, sepse vota është përgjegjësi.



Unë kam zgjedhur atë që e meriton votën time

Eja edhe ti me ne!



Gazetarët e demokracisë raportojnë...



Edhe fëmijët mund të marrin pjesë në vendimmarrje

Më votoni mua



Kandidatët kërkojnë votat tona

MEDIA NË VEPRIM

RISA (10), ARI (10), ELSA (10), ERZA (10), LIZA (11), DIONA (10), DION (11), LEART (10), ENSAR (11)



Si të përdorim median në demokraci?

Kohëve të fundit, teknologjia ka ndryshuar jetën tonë. Ne gjithmonë jemi të lidhur me botën, përmes medias, respektivisht telefonit dhe internetit në këtë rast. Andaj, ne në klasën tonë vendosëm një ditë që të përdorim median për të marrë iniciativë për zgjidhjen e një



Mediat ndahen të shkruara (libra, gazeta, revista, etj) dhe elektronike (radio, telefoni, televizioni, kompjuterët, etj)

problemi që ka kohë që na shqetëson, neve nxënësve të Mitrovicës. Shumica e shkollave në qytetin tonë, kanë mungesë të kabineteve. Përmes rrjetit social të përdorur pothuajse nga të gjithë, ne arritëm të dërgojmë kërkesën tonë deri në Komunë. Si e bëmë këtë? Shumë e thjeshtë. Hapëm një grup në Facebook. Atë e quajtëm „kemi nevojë për kabinete“. Shumë nxënës u anëtarësuan në këtë grup dhe të gjithë e morën shumë seriozisht. Arritëm të mbledhim shumë nënshkrime

edhe nga prindërit tanë.

Komuna kur e kuptoi seriozitetin dhe organizimin tonë, filloi të ndërtoj kabinete në shkollat e Mitrovicës. E shihni pra, lexues të artikullit tonë se me vullnet dhe angazhim të gjitha arrihen.

Meqenëse, media është pjesë e jona çdo ditë, si qytetarë demokratikë që jemi, ne duhet ta shfrytëzojmë për mirë. E shfrytëzojmë që të ndërmarim iniciativa dhe të forcojmë demokracinë.

Duhet përmendur se media njihet si pushteti i katërt në demokraci. Falë medias, ne jemi të informuar çfarë ndodh në vendin tonë, e në tërë botën.

Mos harroni, qytetarët e mirë demokratikë janë gjithmonë të interesuar të informohen se çfarë ndodh



Ne punojmë për vendin tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Abdullah Shabani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Mitrovicë